

**KËRKESË**  
**Nr. 95, datë 14.1.2020**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “FATJON REXHO”**

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: refuzuar.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH VL-2019 000606-5, datë 23.4.2019, për subjektin “Fatjon Rexho”, me adresë: Qarku Vlorë, Sarandë, Lagjja Gjashtë, afër karburant “Vëllezërit Ismaili”.

**KRYEINSPEKTOR**  
**Pandeli Bilbilaj**

**VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT**

Nr. ISHSH-VL-2019-000606-5

Datë 23.4.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-000606-2, datë 23.4.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “Fatjon Rexho”, NIPT K83913807N, përfaqësues i autorizuar i subjektit “Fatjon Rexho”, prej datës 23.4.2019, ora 08:00 deri në datën 23.4.2019, ora 09:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 23.4.2019 dhe e njoftoi në datën 23.4.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

**Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. 36/b.**

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 54, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

**Gjobë 100 000 lekë**

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

- Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Jola Osmeni, ID 0412030001;

Pavjola Zeneli, ID 0412080008.

*Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Fatjon Rexho” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.*